RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO

Nr. 0019/19
Data 13.03.2019
PRISHTINË

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 6, paragrafi 5.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Bordi i RTK-së në mbledhjen e mbajtur më datë 13.03.2019, merr këtë:

VENDIM

I. Rishpallet Konkursi publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

II. Konkursi do të shpallet më datë 15.03.2019 dhe do të jetë i hapur deri më 29.03.2019.

Arsyetim

Më datë 03.12.2018 është mbyllur Konkursi publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së. Komisioni përzgjedhës pas vlerësimit të aplikacioneve ka vlerësuar se së paku tre (3) Kandidatë nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara me konkurs publik, andaj duke u mbështetur në Nenin 6 paragrafi 5.1 e Udhëzimit administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komisioni përzgjedhës merr vendim me të cilin: Konkursi publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së duhet të rishpallet në afat ligjor.

Dy nga kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në Konkursin publik për Drejtor të Përgjithshëm të RTK-së, më datë 27.12.2018 kanë parashtruar ankesë pranë Inspektoratit të Punës.

Inspektorati i Punës më datë 30.01.2019 merr vendim me të cilin ankesën e kandidatëve e konsideron si të pabazuar.

Pas këtij vendimi kandidatët kanë parashtruar ankesë në shkallën e dytë pranë Inspektoratit të Punës.

Shkalla e dytë e Inspektoratit të Punës më date 25.02.2019 ka shqyrtuar ankesën e kandidatëve dhe merr vendim me të cilin ankesën e kandidatëve e konsideron si të pabazuar dhe e vërteton Vendimin e Organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.

Bazuar në faktin se kanë përfunduar të gjitha procedurat ankimore pranë Inspektoratit të Punës, Bordi në mbledhjen e mbajtur më 13.03.2019 merr Vendim me të cilin rishpall Konkursin publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në RTK, i cili do të shpallet me datë 15.03.2019 dhe do të jetë i hapur deri më 29.03.2019.

Vendimi iu dërgohet:

Anëtarëve të Bordit

Sekretarisë së Bordit

Administratës së RTK-së

Afërdita Maliqi

Kryetare e Bordit të RTK-së

A.Maliqi

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS • RADIO TELEVIZIJA KOSOVA • RADIO TELEVISION OF KOSOVO